

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

MBLEDHJE BORDI

VENDIME

Gjatë muajit maj Bordi i ERE-s ka zhvilluar 5 mbledhje, që kanë rezultuar në 21 vendimmarrje, ndër të cilat:

- Rinovimin e licencës së shoqërisë "ENSCO TRADING (ALBANIA)" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Fillimin e procedurave për licencimin shoqërive "FAETHON" shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 93 MW, si dhe "H.K. HEC GRABOVA 2" shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Grabova 2 të përbërë nga HEC Grabova 2/1 dhe HEC Grabova 2/2, me kapacitet total të instaluar 10.8 MW.
- Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë "GSA" shpk në veprimtarinë e furnizimit, të shoqërisë "Ayen As Energji" sh.p.k. Në veprimtarinë e tregtimit dhe të furnizimit të energjisë elektrike, si dhe të shoqërisë "KROI MBRET ENERGJI" sh.p.k. Në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Njohjen e licencës për tregtimin e energjisë elektrike, lëshuar nga ZRRE, për shoqërinë "MFT Energy Kosovo L.L.C", e cili rezulton regjistruar në Republikën e Shqipërisë shoqërinë "MFT ENERGY KOSOVO", degë e shoqërisë së huaj
- Shtyrjen e dy vendimmarrjeve të Bordit, me qëllim saktësimin e disa aspekteve të nevojshme procedurale dhe dokumentare me shoqëritë "5GX ENERGY" shpk si dhe "FU-GEN" sh.p.k.
- Si dhe ndryshime në disa vendimmarrje si rezultat i plotësimit të kushteve të paravendosura, në vendimet e licencimit për shoqëritë "TIRANA ENERGJI" sh.p.k., "TPLANI HC" sh.p.k. Dhe "KESH" sh.a.



Të plota këto vendime gjenden të publikuara në faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

VENDIME

SEANCA DËGJIMORE

Disa nga vendimet e marra gjatë muajit maj lidhen me autoritetin e ERE për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, përcaktimin e pagesave rregullatore, përcaktimin e çmimeve. Të tilla janë vendimet si vijon:

1. Fillimin e procedurës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes mes shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë, me shoqërinë Dragobia Energy sh.p.k. për kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike.
 2. Miratimin e pagesave rregullatore për vitin 2024 që duhet të paguhet nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar dhe Ligjin Nr.102/2015 "Për sektorin e Gazit Natyror" i ndryshuar. Pagesat e miratuara do të paguhet nga të licencuarit jo më vonë se 30 ditë nga botimi i këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.
 3. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin prill 2024 prej 9.84 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
 4. Miratimin e kontratës tip për shit - blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, (KESH sh.a.) dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a. për periudhën kohore 01/01/2024 - 31/12/2024.
 5. Miratimin e "Metodologjisë së shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës".
 6. Miratimin e "Procedurave rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri - Kosovë".
 7. Miratimin e pjesshëm të kërkesës së ALPEX për miratimin e "Listës së tarifave për tregun brenda së njëjtës ditë", të cilat do jenë të aplikueshme deri me 31.08.2024 për operatorin e emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO).
- Për tu njohur me këto vendime dhe të tjera, në mënyrë më të detajuar, ju ftojmë të vizitoni faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al në kategorinë [vendime](#).

Gjatë muajit maj, pjesë e aktivitetit të ERE-s kanë qënë dhe tre seanca dëgjimore të zhvilluara për zgjidhjen e ankesave dhe marrjen e qëndrimeve të palëve me qëllim një vendimarrje më të plotë.

Duke shfletuar faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al, mund të njiheni me të dhënat e fundit të [tregut të energjisë](#) në vend, regjistrat e [licencimit të subjekteve](#), [të garancive të origjinës](#) dhe të [ankesave](#) të rifreskuar, si dhe [tarifa dhe çmime](#) të miratuara nga ERE. Në zërin [konsultime](#), ju ftojmë gjithashtu të lexoni materiale të ndryshme mbi të cilat mund të dërgoni opinionin tuaj si palë interesi, në adresën tonë të e-mailit erealb@ere.gov.al.

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

AKTIVITETE

Në datën 8 maj Ambasada Italiane për Shqipërinë organizoi takimin në Tiranë lidhur me përfundimin e projektit KEP financuar nga CEI (Iniciativa Qëndrore Evropiane) dhe prezantimin e raportit përfundimtar të përgatitur nga ARERA (Zyra e Rregullatorit Italian) mbi ecurinë e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri, sfidat dhe përvoja Italiane në këtë fushë. Gjatë këtij takimi në fjalën e mbajtur, kryetari i ERE-s Z. Ahmeti, falenderoi Ambasadën Italiane dhe ARERA-n për studimin dhe suportin si dhe për seminarin e zhvilluar në kuadër të projektit për shkëmbimin e eksperiencave midis të dy Rregullatorëve dhe palëve të interesit si TSO-ve dhe Bursave të enegjisë. Po ashtu, në panelet me përfaqësues të Rregullatorëve, TSO-ve, Bursave të enegjisë elektrike të Shqipërisë dhe Italisë si dhe palëve të interesit, nga ana e Z. Radheshi u diskutua mbi rolin e ERE-s, pritshmëritë dhe sfidat që i dalin rregullatorit në vijim në kuadër të bashkimit të tregjeve të vendeve të Ballkanit Perëndimor me tregjet Evropiane. Në datën 9 Maj u zhvillua në Tiranë Seminari i 6-të i BES – Shkolla Ballkanike e Energjisë me temë “Dizajni i ri i tregut të energjisë elektrike dhe implikimet e tij në Ballkan”, pjesë e projektit KEP. Në të u trajtuan tema të që lidhen me sfidat e sektorit dhe eksperiencave të vendeve të BE-së në këtë kuadër. ERE është një ndër anëtarët themelues dhe aktive të Shkollës Ballkanike të Energjisë – BES, që prej dhjetorit 2022.



Në datën 15 maj, me miratim të ministrit të ekonomisë, kulturës dhe inovacionit z.Gonxhja u mbajt mbledhja e Këshillit Bashkërendues të Mbrojtjes së Konsumatorit. Në këtë takim u bë edhe prezantimi i Strategjisë Ndërsëktoriale të Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mbiqëqyrjes së Tregut 2024 - 2030, në të cilën ka dhënë kontributin e tij edhe Enti Rregullator i Energjisë. Në cilësinë e kontribuesve të rëndësishëm të këtij dokumenti, si një institucion që në fokus të punës ka mes të tjerave edhe mbrojtjen e konsumatorit, zgjidhjen e ankesave të tyre dhe sensibilizimin e konsumatorit në lidhje me të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga kontrata e energjisë elektrike e aktet e miratuara për këtë qëllim, Znj Erjola Sadushi, Komisionere e Bordit të ERE dhe Znj Julia Cuga, Drejtore e Drejtorisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, prezantuan kontributin e ERE në këtë projekt ambicioz ndërsëktorial e iu përgjigjen pyetjeve të Këshillit bashkërendues të ngritur me Urdhër të Kryeministrit, sipas fushës së përgjegjësisë. Edhe më herët në vitin 2021 ERE ka miratuar Objektivat strategjike të rinovuar për një afat 3 vjeçar në fillim të vitit 2024, të cilët janë në harmoni me sa parashikuar në strategjinë Ndërsëktoriale të Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mbiqëqyrjes së Tregut 2024 – 2030.

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

AKTIVITETE



PJESËMARRJE

Qendra e Konsumatorit Shqipëtar, në kuadër të Akademisë së Konsumatorit, në datën 17 maj, ftoi në Akademi Znj. Erjola Sadushi, Komisionere e Bordit të ERE dhe Znj. Julia Guga, Drejtore e Drejtorisë së Mbrojtjes së Konsumatorit. Përfaqësueset e ERE trajtuan tema që lidhen me kontratat e furnizimit me energji elektrike, kushtet e cilësinë e shërbimit të furnizimit, të drejtat kontraktuale të konsumatorit si dhe ato të garantuara me ligj etj. Për pjesëmarrësit u shpjeguan me një fokus të veçantë, modalitetet e trajtimit e zgjidhjes së ankesave në ERE, si dhe roli që ERE ka në mbrojtjen e konsumatorit. Pjesë e agjendës së akademisë, ishte dhe bashkëbisedimi me pjesëmarrësit për të adresuar pyetjet e tyre të shumta në lidhje me këtë sektor të rëndësishëm e mënyrën e funksionimit të tij.

Më 30 maj, gjatë mbledhjes së saj të përgjithshme, AIB - Shoqata e lëshuesve të garancive të origjinës me seli në Riga, Letoni, pranoi kërkesën e ERE-s dhe votoi në unanimitet për pranimin si anëtare me të drejta të plota në shoqatë. AIB, e cila përbëhet nga më shumë se 37 organe lëshuese të garancive të origjinës së burimeve të rinovueshme, ndër të cilat 30 janë vende të BE-së, zhvillon dhe promovon standardizimin e sistemeve të lëshimit, transferimit dhe anulimit të garancive të origjinës për energjinë elektrike dhe gazin natyror në vendet anëtare të shoqatës. Gjatë fjalës së saj Sekretarja e Përgjithshme e AIB Znj. Liesbeth Switten, pasi bëri një përmbledhje të rolit dhe aktivitetit të ERE-s në lëshimin e garancive të origjinës përputhje me Ligjin 24/2023 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", shprehu kënaqësinë për anëtarësimin e ERE-s në shoqatë. Në fjalën e tij Sekretari i Përgjithshëm i ERE-s Z. Elton B. Radheshi pasi falenderoi anëtarët për mbështetjen dhe anëtarësimin në këtë organizëm të rëndësishëm, informoi shkurtimisht masat e marra nga ERE në kuadër të mbajtjes së regjistrit elektronik të garancive të origjinës sipas standardit të Vendeve të Traktatit të Energjisë i cili është po ashtu në përputhje me standardet e EU-së si dhe masave që do të merren në të ardhmen për adaptimit në Shqipëri të sistemit Evropian të çertifikimit të energjisë së rinovueshme dhe pjesëmarrjen në HUB-in Evropian të lëshimit, transferimit dhe anulimit të Garancive të Origjinës. Pjesëmarrja në AIB dhe sistemin Evropian të garancive të origjinës do ti jap vlerë të shtuar prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme në Shqipëri, si një ndër vendet me përqindjen më lartë prodhimit të energjisë elektrike nga këto burime si dhe sfidave në kuadër të arritjes së uljes së emetimeve të karbonit në net zero.

